



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:131336

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491359

C.nr.265/22

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. K.me vendbanim në fshatin T./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, rruga "Luan Haradinaj" nr.99, të cilën sipas ligjit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti: "Kompensimi i shujtave, shtesave për kualifikim shkollor dhe pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë)", vlera e kontestit **2,437.00 euro**, jashtë seancës gjyqësore me datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Pa shqyrtim kryesor të çështjes-

- I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit G. K.nga fshati T./Malishevë.
- II. **DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, që paditësit G. K. t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej **2,437.00** dhe atë:
 - a) Në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 580.24 € ose në total shumën prej **2,320.96 €** (paga 580.24 euro x 4 vite = 2,320.96 euro) dhe
 - b) Në emër të shpërblimit të shtesave në pagë për kualifikim shkollor (diplomë universitare-bachelor, fakulteti), për periudhën nëntor 2018 deri në shkurt 2022 ose për 40 paga, t'ia paguaj shumën prej **116.04 euro** (Paga bazë 580.24 kur e kalkulojmë me 0.5%, shuma del të jetë 2.9012 euro, e kur këtë e shumëzojmë me 40 paga, shuma del të jetë 116.04 euro (2.9012 euro x 40 paga = 116.04 euro), të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, e cila fillon të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (28.04.2022) e deri në pagesën definitive.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, ose shumën prej 4,405.24 € dhe atë në emër të pagës së trembëdhjetë për fund vitin 2022 në shumën prej 580.24 euro dhe në emër të kompensimit për ushqim (shujta) shumën prej 3,825.00 euro.

IV. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 134.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi Gëzim Krasniqi të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 28.04.2022 ka paraqitur padi kundër të paditurës Policia e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shujtave, shtesave për kualifikim dhe pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë), me arsyetimin se paditësi ka kontratë pune me kohë të pacaktuar me të paditurën në pozitën e zyrtarit policor nga data 24.07.2000, i njëjti i ka të përfunduara edhe studimet baçelor, kurse gjatë periudhës 2018-2021 ka performancë të shkëlqyer dhe nuk ka marrë asnjë vërejtje, kështu që bazuar me dispozitën e nenit 29 par. 1, 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, ka theksuar se i takojnë këto të drejta.

Paditësi ka theksuar se ka parashtruar kërkesë të punëdhënësi për kompensimin e shujtave ditore, kualifikimin shkollor me diplomë universitare-fakultet 0.5% dhe pagesën e një page mujore në fund të çdo viti kalendarik, mirëpo e paditura nuk është përgjigjur, andaj duke u ndodhur në këtë situatë, paditësi është detyruar të parashtrroj padi për kompensimin e kërkesave të tij.

Nga arsyet e paraqitura në padi, paditësi ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, dhe ta obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të shujtave ditore t'ia paguaj nga 5 euro për një ditë pune, respektivisht për 765 ditë, t'ia paguaj shumën prej 3,825.00 euro, në emër të kompensimit të pagesës së një page mujore ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 2,320.96 euro dhe në emër të shtesës në pagë për kualifikim shkollor-diplomë universitare (fakultet) prej 0.5% të pagës 580.24 euro, për periudhën nëntor 2018 deri në shkurt 2022 ose për 40 paga, t'ia paguaj shumën prej 116.04 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga dita kur kërkesat kanë arritur për përmbushje e deri në pagesën përfundimtare.

I autorizuari i paditësit, me datën 20.02.2024, me parashtrësë për precizimin e padisë ku përveç dorëzimit të disa provave, ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadisë ashtu që ka kërkuar ti kompensohet paga e trembëdhjetë edhe për vitin 2022 në shumën prej 580.24 euro ose për pesë (5) paga të trembëdhjeta (2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022) në shumën prej 2901.20 euro, kurse

pjesa tjetër e petitumit mbetet e pandryshuar edhe pse ka thënë se në bazë të listës së pagave, paditësi ka realizuar pagë më të lartë, mirëpo i njëjti kërkon vetëm lartësinë e pagës bazë sipas vërtetimit të punësimit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 156.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore, shumë prej 61.00 euro.

E paditura në përgjigjen e saj në padi të cilën e kemi pranuar me datë 28.02.2024 dhe parashtrësës së datës 05.03.2024 e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar duke shtuar se paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme të ankimit siç parashihet me nenin 78 dhe 79 të Ligjit nr.03/L-212 i punës, dhe po ashtu është thirrur në parashkrim, pasi thotë se me nenin 87 të po këtij ligji parashihet se kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh.

Ka shtuar se Udhëzimi Administrativ (UA) nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në polici, ku paditësi e ka mbështetur kërkesëpadinë, është i shfuqizuar nga UA nr.01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 dhe nuk mund të aplikohet për periudhën 2022, ndërsa duke u bazuar në nenin 45 par.2 të ligjit të pagave 2023, shfuqizohet çdo dispozitë e ligjit apo aktit nënligjor.

Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 par.4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj, çdo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm, përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar dhe në mungesë të mjeteve, nuk ka mundur të realizohet paga e 13-të.

Duke u bazuar edhe në sqarimet e bëra më lart, e paditura përsëri thekson se e kundërshton padinë, sepse kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale dhe se asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund ta ketë obligim. Sipas të paditurës, të vetmin obligim ligjor ndaj paditësit e ka përmbushjen e kontratës së punës dhe se paditësi do të mund të kompensohet për kërkesën e tij brenda mundësive, andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën.

Në fund i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim me të cilin do ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Provat dhe vlerësimi i tyre

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Kërkesën e paditësit për kompensim të shujtave, kualifikim shkollor dhe pagës shtesë, drejtuar të paditurës nr.... të datës 21.03.2022, vërtetimin e punësimit nr. ref. ... të datës 23.02.2022, Kontratën e punës nr.... e datës 11.05.2010 e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, diplomën universitare nr.... të datës

25.02.2022, listat e pagave, lista për ditët e angazhuara në punë për periudhën 2018-2022 dhe formularët e vlerësimit të performancës për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit nr. ref. ..., dhe kontrata e punës nr.... të cilat janë lëshuar nga vetë e paditura.

Nga kërkesa me nr.... e datës 21.03.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka bërë kërkesë tek e paditura për pagesë të shujtave, kualifikim shkollor dhe pagës shtesë, por nuk ka marrë përgjigje.

Nga kontrata e punës vërtetohet se zyrtari policor G. K.ka kontratë pune me kohë të pacaktuar, kurse nga vërtetimi i punësimit i cekur më lart, gjykata konstatoi se paditësi e ka filluar punën te e paditura nga data 24.07.2000 dhe realizon pagë mujore në shumën prej 580.24 €, ndërsa bazuar në listat e pagave paditësi realizon pagë më të madhe duke futur këtu edhe ndërrimet e natës, rrezikshmërinë dhe kompensimet tjera.

Nga shikimi i diplomës universitare nr.224/22 të datës 25.02.2022 të lëshuar nga kolegji “AAB”, vërtetohet fakti se paditësi i ka mbaruar studimet me datë 25.06.2014 në programin Juridik dhe ka marrë gradën LLB në Juridik.

Bazuar në listat për ditët e angazhuara në punë për periudhën nëntor 2018 deri shkurt 2022, vërtetohet se paditësi ka qenë i angazhuar në punë gjithsej 765 ditë.

Nga formularët e vlerësimit të performancës për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur vlerësim me notën 4 dhe 5 që korrespondon me vlerësimin plotësisht të kënaqshëm dhe tejkalon kërkesat.

Vërtetimin, kontratën e punës si dhe formularët e lartcekur, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, andaj vërtetimit dhe kontratës me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit, gjykata ua fali besimin e plotë.

Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, që në këtë rast rezulton se padia e paditësve është pjesërisht e bazuar për arsye se:

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 të LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën tjetër (refuzuese) të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se lidhur me kërkesën e aprovuar pjesërisht të paditësit për kompensimin e pagës së 13-të për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe kërkesën e aprovuar lidhur me kompensimin e shtesave në pagë me kualifikim shkollor, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (UA) Nr.02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 dhe UA nr.01/2021 i datës 29.09.2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe po ashtu bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.... të datës 09.10.2023 për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*, ndërsa me nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*, kurse neni 55 par.1 nën par.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 të datës 14.11.2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, kurse neni 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcakton se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”*, ndërkaq bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, në pikën -II- është paraparë se *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të*

nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”.

Lidhur me aprovimin e shpërblimit të shtesave në pagë për kualifikimin shkollor të personelit policorë, me nenin 29 paragrafi 3 të UA nr.02/2018 është paraparë: “Shtesat në pagë për kualifikim shkollor janë si në vijim: 3.1. **diplomë universitare (baçelor, fakulteti) 0.5%**, 3.2 master, magjistër i shkencave 1%, 3.3. doktoratë PhD 2%”, kurse njëjtë parashihet edhe me nenin 30 paragrafi 3 të UA nr.01/2021 ku përcaktohet se: “Shtesat në pagë për kualifikimin shkollor janë si në vijim: 3.1. **diplomë universitare (baçelor, fakulteti) 0.5%**, 3.2 master, magjistër i shkencave 1%, 3.3. doktoratë PhD 2% “, ndërkaq këtu duhet bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, ku në pikën -III- parashihet se: “Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollorë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022”.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara, të Udhëzimeve Administrative 02/2018 dhe 01/2021 të nxjerra nga e paditura, Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, sepse paditësi e gëzon të drejtën në shpërblimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollor dhe po ashtu të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësi i të paditurës, në këtë rast paditësi, të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe të mos i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës.

Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi ka vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit.

Me rastin e vendosjes lidhur me detyrimin si në pikën -II- të dispozitivit dhe lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori

për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga i cili rezulton paga e paditësit, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 i takon shuma ashtu siç edhe është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi (paga 580.24 euro x 4 vite = 2,320.96 euro), kurse lidhur me kompensimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollor, gjykata ia ka njohur paditësit për periudhën nëntor 2018 deri shkurt 2022 ose për 40 paga, pra paga bazë 580.24 kur e kalkulojmë me 0.5%, shuma del të jetë 2 euro e 9,112 cent, e kur këtë e shumëzojmë me 40 paga, shuma del të jetë 116.04 euro (2.9112 euro x 40 paga = 116.04 euro).

Gjykata vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara për ta kompensuar paditësin për pagën e 13-të për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe për kompensimin e shtesave në pagë për kualifikimin shkollor, andaj në këtë rast paditësi e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit dhe kjo bazuar edhe me nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Së këndejmi gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta aprovoj pjesërisht kërkesën dhe ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e gjykuar si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 par. 2 i LMD-së dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 28.04.2022 si ditë e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Pjesa refuzuese

Lidhur me refuzimin e pjesërishtëm si në pikën -III- të dispozitivit për shpërblimin e pagës, më konkretisht pagës së 13-të për fund vitin 2022 ose shumën prej 580.24 euro, gjykata është bazuar në Udhëzimin Administrativ (UA) nr.01/2021 i datës 29.09.2021 ku me nenin 30 par. 2 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”* dhe gjithashtu është bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, ku në pikën -II- është paraparë se *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”*.

Pra, bazuar në nenin 30 par. 2 të UA 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, rezulton se realizimi i shpërblimi është i kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore, derisa neni 29 par. 2 të UA 02/2018 i datës 14.11.2018 dhe i cili ka qenë në fuqi deri me datën 29.09.2021, ka qenë i karakterit detyrues dhe punëdhënësi është i obliguar që edhe për vitin 2021 të planifikoj mjetet buxhetore, e jo edhe për vitin 2022.

Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesën e paditësit për kompensimin e shujtave ditore për gjithsej 765 ditë pune për periudhën kohore nëntor 2018 e deri në muajin shkurt 2022, apo shumën prej 3,825.00 €, sepse me paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, dhe pasi që kjo dispozitë ligjore nuk e detyron shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtës ditore ashtu siç ka kërkuar paditësi, gjykata vendosi si në pikën -III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe po ashtu duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se: *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021”*.

Pra, duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, rezulton se përfshirja e shpërblimit të shujtës ditore është e karakterit deklarativ dhe nuk përcaktojnë detyrime konkrete për punëdhënësin, por vetëm theksojnë se duhet të jenë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, gjithashtu nuk janë përcaktuar as kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës ditore.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoj detyrimin me pretendimin se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, dhe lidhur me këtë, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër, derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimi që rezulton nga dispozitat e lartcekura përderisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç ka kërkuar paditës për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë paditësi nuk i ka shtetur mjetet e brendshme të ankimit dhe po ashtu është thirrur në parashkrim, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësi ka kërkuar fillimisht që të kompensohet drejtpërdrejt te i padituri.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -IV- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, si dhe në bazë të rregullores për tarifat e avokatëve, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 134.00 euro dhe atë: në emër të parashtrimit të padisë t’ia paguajë shumën prej 104.00 euro (sipas numrit tarifar 6 të rregullores për tarifat e avokatëve në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri ne 10.000 €) dhe shumën prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore (sipas tarifës së taksave gjyqësore 1,001.00 deri 2,500.00 euro – taksë është 30.00 euro), ndërsa është refuzuar pjesa e kërkuar përtej kësaj shume, ngase nuk mund të ngarkohet e paditura me shpenzimet e panevojshme dhe të paarsyeshme të paditësit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 152 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.265/22, datë 22.03.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.